

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Auditim**  
**(zgjidhjet)**

**P6**

Data 25/01/2020

## Detyra 1

Jeni duke filluar auditimin e një klienti të madh, A&A. A&A është një kompani e shpërndarjes me shumicë të produkteve të qumështit dhe operon në tre vendet e regjionit, Kosovë, Maqedoni dhe Shqipëri. Në secilin shtet, kompania ka nga një depo me frigorifer ndërsa operacionet janë të centralizuara nga Kosova në të cilën gjendet funksioni i blerjes dhe kontabilitetit. Si pjesë e auditimit, ju duhet të rishikoni edhe përbërësit e kontrollit të brendshëm të kompanisë.

### Kërkohe:

- (a) Shpjegoni se çka nënkuptohet me 'mjedisin e kontrollit'. (3 pikë)
- (b) Pse është e rëndësishme për auditorin të përftoj njohuri për kompaninë dhe mjedisin e kontrollit, përfshirë kontrollet e brendshme të kompanisë? (6 pikë)
- (c) Tregoni KATËR faktorë që pritet nga auditorit të gjej në operimin e mjedisit të kontrollit të A&A. (4 pikë)
- (d) Tregoni KATËR aktivitete të ndryshme të kontrollit të cilat duhet të gjinden në A&A dhe ofroni nga një shembull specifik për secilën. (8 pikë)
- (e) Diskutoni KATËR kufizime të vetvetishme të sistemit të kontrollit të brendshëm. (4 pikë)

**[Total: 25 pikë]**

## Zgjidhja 1

### (a) Mjedisi i kontrollit

Mjedisi i kontrollit të një kompanie i referohet mjedisit të krijuar nga drejtorët përmes sjelljeve së tyre, veprimeve, vetëdijes ndaj kontrolleve të brendshme të kompanisë dhe rëndësisë së tyre.

### (b) Njohja me entitetin dhe mjedisin

Njohja me entitetin dhe mjedisin e tij i ofron auditorëve një kornizë përmes së cilës mund të planifikojnë auditimin dhe ushtrojnë gjykimin profesional përgjatë auditimit kur:

- Vlerësojnë rrezikun e anomalive materiale në pasqyra financiare
- Përcaktijnë materialitetin dhe vlerësojnë nëse niveli i materialitetit mbetet i përshtatshëm përgjatë tërë auditimit
- Konsiderojnë përshtatshmërinë e përzgjedhjes dhe zbatimit të politikave kontablë dhe mjaftueshmërinë e shpalosjeve në pasqyra financiare
- Identifikojnë fushat që kërkojnë konsiderata të veçanta, psh, transaksionet me palë të lidhura, përdorimi i përshtatshëm i hipotezës së vijimësisë ose konsiderimi i qëllimit biznesor të transaksioneve
- Zhvillojnë pritje në përdorimin e procedurave analitike
- Përgjigjen ndaj rrezikut të vlerësuar të anomalive materiale përfshirë dizajnimin dhe kryerjen e procedurave të auditimit për të përftuar dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme
- Vlerësojnë mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë e dëshmive të auditimit

### (c) Faktorët kyç që duhet të reflektojnë mjedisin e kontrollit:

- Si komunikohen parimet e integritetit dhe vlerave etike dhe si fuqizohen brenda kompanisë
- Konsiderimi i nga menaxhmenti i nivelit të kompetencave që kërkohen për një punë të caktuar dhe si përkthehet kjo në aftësi dhe njohuri të nevojshme
- Sjellja e bordit ndaj biznesit dhe në veçanti nga drejtorët ekzekutiv, përvoja e ture dhe niveli i përfshirjes së tyre në kompani, informatave që ata pranojnë, kontrollimi i aktiviteteve të kompanisë nga drejtorët dhe shkalla e bashkëveprimit të tyre me auditorët e jashtëm

- Filozofia dhe stili operativ i drejtorëve ekzekutiv, në veçanti, qasja e tyre ndaj rreziqeve të biznesit, sjellja ndaj funksionit të kontabilitetit, procesimit të informatave dhe raportimit financiar
- Struktura organizative dhe kujdesi se si kompania planifikon, përpiqet të arrijë, kontrolloj dhe rishikoj objektivat e saj
- Si caktohet autoriteti dhe përgjegjësia dhe si përcaktohen marrëdhëniet e raportimit dhe hierarkia e autorizimit
- Politikat e burimeve njerëzore dhe praktikat lidhur me rekrutimit, orientimin, trajnimin, vlerësimin, kompenzimin, etj.

(d) Kategoritë e aktiviteteve të kontrollit dhe shembujt

Aprovimi dhe kontrolli mbi dokumentet

- Aprovimi i regjistrimeve në kontabilitet nga anëtarët senior të departamentit të kontabilitetit
- Aprovimi i listave të pagave nga menaxheri përgjegjës

Kufizimi i qasjes direkte në pasuri dhe regjistra

- Mbrojtja me fjalëkalime e qasjes në ndryshimin e të dhënave të çmimeve të shitjes
- Kufizimi i qasjes në departamentin e arkëtarëve
- Kufizimi i qasjes në depo të mallrave

Procedurat për autorizimin e transaksioneve

- Autorizimi i urdhërblereve nga menaxheri përgjegjës

Ndarja e detyrave

- Ndarja e duhur e detyrave në tërë ciklin e shitjeve, administratimit dhe departamentin e kontabilitetit

(e) Kufizimet e vetvetishme të sistemeve të kontrollit të brendshëm:

- Kosto të mos tejkaloj përfitimin nga kontrollet
- Mundësia e gabimeve njerëzore
- Mundësia e marrëveshjeve të fshehta në mes të punonjësve ose menaxherëve për të anashkaluar kontrollet
- Mundësia e anashkalimit të kontrolleve nga menaxhmenti
- Sistemet e dizajnuara të trajtojnë vetëm transaksionet rutinore dhe dështojnë në rastin e transaksioneve jorutinore

## Detyra 2

Ju jeni senior i auditimit në firmën Qershia-Audit dhe jeni duke planifikuar auditimin e Molla-IT për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2019. Kompania prodhon pajisje mobile muzikore dhe ju së bashku me menaxherin e auditimit keni pasur takimin e planifikimit me drejtorin financiar.

Të hyrat e parashikuara janë €68.6m, fitimi para tatimit është €4.2m. Drejtori financiar ju ka ofruar edhe informatat në vijim:

Stoqet vlerësohen sipas kostos ose vlerës neto të realizueshme, cilado që është më e ulët. Kosto përbëhet nga lënda e parë dhe kosto e konvertimit, pëfshirë punën, dhe shpenzimet e përgjithshme të prodhimit. Stoqet mbahen në tri depo të shpërndara në tërë vendin. Kompania planifikon të kryej numërimin e stoqeve me 2, 3 dhe 4 janar 2020 në të cilën kohë do të bëhen të gjitha korrigjimet për të reflektuar lëvizjet e stoqeve pas fundit të vitit. Ekipi i auditimit të brendshëm do të merr pjesë në numërim.

Gjatë vitit, Molla-IT ka paguar €1.1m për të blerë një patentë e cila i lejon të drejta ekskluzive kompanisë për të përshtatur pajisjet e tyre muzikore për të përfituar përparësi konkurruese në industrinë që operojnë. Shuma prej €1.1m është paraqitur si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave të vitit. Për të financuar këtë blerje, kompania ka emetuar €1.2m aksione me premium. Në gusht të vitit 2019, është zbuluar se ka ndodhur një mashtrim i madh nga katër punonjësit e departamentit të librit të shitjes të cilët kishin pasur një marrëveshje të fshehtë në mes vete. Ata kishin vjedhur paratë nga konsumatorët me shumicë dhe për të mbuluar këtë, ata më vonë i kishin alokuar shumat në libra ndaj llogarive të vjetra të arkëtueshme. Të gjithë të punonjësit ishin raportuar në polici dhe më pas ishin përjashtuar nga puna. Si rezultat i mungesës së personelit në departamentin e librit të shitjeve, kompania vendosi të kontraktojë një organizatë të jashtme për këto shërbime. Organizata për shërbime i trajton të gjitha elementet e ciklit të librit të shitjes, përfshirë faturimin e shitjeve dhe ndjekjen e saldove të llogarive të arkëtueshme dhe dërgon raporte mujore të Molla-IT në të cilin detajohen shitjet dhe shumat e arkëtueshme. Molla-IT ka mbajtur librin e vet të shitjes deri me 31 tetor 2019 dhe nga ajo datë i ka transferuar organizatës për shërbime. Në nëntor 2018, kontabilisti i kompanisë ishte larguar nga puna. Ai ishte punësuar në kompani për nëntë vite dhe kishte kërcënuar të padiste kompaninë për largim të padrejtë nga puna. Si rezultat i këtij largimi nga puna, dhe deri në datën e zëvendësimit të tij në mars të 2019, përgjegjësia e kontabilistit financiar ishte shpërndarë në mënyrë të duhur tek anëtarët tjerë të departamentit të financave. Mirëpo, për këtë periudhë nuk ishte kryer asnjë harmonizim me kartelat e furnitorëve e as llogarisë kontrolluese të librit të blerjes. Në shtator të vitit 2018, një saldo prej €0.9m e një llogarie të arkëtueshme ishte shlyer nga librat si borxh i keq pasi që konsumatori i kompanisë kishte bankrotuar. Në nëntor të vitit 2019, likuiduesit e konsumatorit kishin shpallur publikisht lajmin se të gjithë kreditorët e kompanisë do të pranojnë pagesë në vlerë prej 40% të saldove që kishin borxh. Si rezultat i kësaj, Molla-IT ka përfshirë një pasuri qarkulluese prej €360,000 në pasqyrën e pozicionit financiar dhe si e hyrë tjetër në pasqyrën e të ardhurave.

### Kërkohet:

- (a) Përshkruani përgjegjësitë e firmës së auditimit lidhur me parandalimin dhe zbulimin e mashtrimit dhe gabimit. (4 pikë)
  - (b) Përshkruani TETË rreziqe të auditimit dhe shpjegoni përgjigjet e auditorit ndaj rreziqeve në planifikimin e auditimit të Molla-IT.
- Shënim: Paraqitni përgjigjet tuaja në dy kolona me titujt Rreziku i Auditimit dhe Përgjigja e Auditorit (16 pikë)

[Total: 20 pikë]

## Zgjidhja 2

### (a) Përgjegjësia ndaj mashtrimeve

Auditorët duhet të kryej auditimin në pajtueshmëri me SNA 240 Përgjegjësitë e auditorit lidhur me mashtrimin në një auditim të pasqyrave financiare dhe për të përfutur siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Në mënyrë që të përmbushet kjo përgjegjësi, auditorët duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë rrezikun e anomalisë materiale për shkak të mashtrimit. Auditorët duhet të përftojnë dëshmitë miftueshme dhe të përshtatshme të auditimit lidhur me rrezikun e vlerësuar të aomalisë materiale përmes dizajnit dhe zbatimit të procedurave të përhtatshme të auditimit. Përveç kësaj auditorët duhet të përgjigjen në mënyrë të përshtatshme ndaj mashtrimit ose mashtrimit të dyshuar që është identifikuar gjatë auditimit. Auditorët duhet të mbajnë skepticizmin profesional gjatë tërë auditimit duke konsideruar mundësinë e anashkalimit të kontroleve nga menaxhmenti dhe se procedurat që mund të jenë efektive për të zbuluar gabimet mund të mos jenë efektive për zbulimin e mashtrimit. Për tu siguruar se ekipi i auditimit është i vetëdijshëm për rreziqet dhe përgjegjësitë për mashtrimet dhe gabimet, SNA 240 kërkon diskutim në mes të ekipit.

### (b)

Rreziku i auditimit	Përgjigja e auditorit
Kompania vlerëson stoqet sipas kosos ose VNR cila do që është më e ulët. Kosto përfshin shpenzimet e përgjithshme të prodhimit. SNK 2 kërkon që kostot e përfshira në stoqe të jenë vetëm ato që ndodhin për të sjellur stoqet në gjendje dhe në vendndodhjen e tanishme. Edhe pse shpenzimet e përgjithshme të prodhimit i përmbushin këto kritere, shpenzimet tjera të përgjithshme nuk i përmbushin ato prandaj stoqet mund të jenë mbivlerësuar	Diskutoni me menaxhmentin për natyrën e shpenzimeve të përgjithshme që janë përfshirë në stoqe. Nëse ka shpenzime që nuk përmbushin kriterin e SNK 2 atëherë ato duhet të përjashtohen. Rishikoni dokumentet mbështetëse dhe analizoni kostot nëse kanë natyrë të prodhimit.
Kompania është duke planifikuar të numëroj stoqet pas fundit të vitit dhe pastaj të korrigjoj lëvizjet nga fundi i vitit deri në datën e numërimit. Nëse korrigjimet nuk janë të sakta, atëherë stoqet e fundvitit mund të jenë nën/mbivlerësuar.	Auditori duhet të merr pjesë në numërimin e stoqeve pas fundit të vitit dhe të merr shënime për stoqet e pranuar/dërguara për të harmonizuar lëvizjet. Gajtë auditimit, auditori duhet të rishikoj tabelat e korrigjimeve të stoqeve dhe të përputh me dokumentet e përfutura gjatë numërimit të stoqeve. Ekipi i auditimit duhet të rrisë shtrirjen e testeve të prerjes nga data e fundit e vitit deri në datën e numërimit të stoqeve.
Është blerë një patent për €1.1m dhe kjo i ofron kompanisë përshtatje të pajisjeve për të fituar një përparësi konkurruese në treg. Menaxhmenti ka shpenzuar tërë shumën në pasqyrën e të ardhurave të vitit. Në pajtueshmëri me SNK 38 Pasuritë e patrupëzuara, kjo shumë është dashur të njhet si pasuri dhe të amortizohet brenda periudhës trevjeçare. Pasi që shumë është shpenzuar dhe nuk është ëtrajtuar sipas SNK 38, pasuritë e patrupëzuara dhe fitimet janë nënvlerësuar.	Auditori duhet të përputhë çmimin e blerjes me dokumentet mbështetëse dhe të konfirmoj jetën e përdorimit prej 3 viteve sipas kontratës. Diskutimi me menaxhmentin arsyen e shpenzimit të shumës së paguar dhe të kërkohet korrigjimi i pasqyrave financiare. PAsaj auditorit do të rishikoj regjistrimet në ditar të korrigjimit dhe llogaritjes së shpenzimit të amortizimit.
Gajtë vitit kompania është financuar në vlerë	Ekipi i auditimit duhet të konfirmoj se të hyrat

<p>prej 1.2m përmes shitjes së aksioneve me premium. Kjo duhet të trajtohet saktë dhe të shpalojë si duhet në PF dhe të ndahet si duhet në mes të kapitalit aksionar dhe premisë së aksioneve. Nëse nuk bëhet kështu atëherë ekuiteti i kompanisë mund të përmbajë anomali materiale.</p>	<p>janë pranuar prej €1.2m dhe ndarja në mes të kapitalit aksionar dhe premisë së aksioneve është e saktë. Gjithashtu duhet të rishikohet edhe shpalosja e shumava siç kërkohet me standardet përkatëse.</p>
<p>Në gusht 2019 është zbuluar se ka ndodhur një mashtrim i kryer nga katër punonjës të departamentit të librit të shitjes. Ka rrezik se nuk është përcaktuar shuma e plotë e mashtrimit prandaj do të duhej që transaksione shtesë të fshihen nga librat. Nëse këto mashtrime nuk zbulohen atëherë pasqyrat financiare mund të përmbajnë anomali materiale dhe llogaritë individuale të LLA mund të jenë të nën/mbivlerësuar.</p>	<p>Diskutoni me drjetorin financiar cilat procedura kanë ndjekur për të indentifikuar dhe kuantifikuar ndikimin e mashtrimit. Përveç kësaj diskutoni çfarë kontrole janë vënë në funksion për të identifikuar mashtrie të ngjashme. Rishikoni listën e të arkëtueshmeve për të identifikuar regjistrime të pazakonta pasqi që kjo mund të jetë dëshmi se transaksioneve tjera mashtruese. Ekipi i auditimit duhet të mbajë skepticizmin profesional në nivel të lartë gjatë gjithë auditimit.</p>
<p>Gjatë vitit kompania ka kontraktuar funksionin e librit të shitjes te një organizatë për shërbime. Mund të kemi rritje të rrezikut të moszbulimit nëse dëshmitë e auditimit nuk janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të konfirmuar plotësinë dhe saktësinë e kontrolleve mbi ciklin e shitjeve dhe të arkëtueshme.</p>	<p>Diskutoni me menaxhmentin deri në çfarë mase mbahen regjistrat nga organizata për shërbime dhe si monitorohen kontrollet nga menaxhmenti mbi shitjet dhe të arkëtueshmet. Duhet të konsiderohet kontaktimi i organizatës për shërbime për të konfirmuar nivelin e kontrolleve.</p>
<p>Procesimi i transaksioneve të librit të shitjeve është transferuar te organizata për shërbime. Nëse ka ndodhur ndonjë gabim gjatë transferimit të procesit, kjo mund të rezultojë me nën/mbivlerësim të shitjeve dhe llogarive të arkëtueshme.</p>	<p>Diskutoni me menaxhmentin procesin e transferimit dhe kontrollet e vendosura për të siguruar plotësinë dhe saktësinë e të dhënave. Nëse është e mundur, kryeni testet e kontrolleve dhe testet e pavarura për transferimin e informatave nga sistemi i vjetër në sistemin e ri.</p>
<p>Kontabilisti i kompanisë ishte larguar dhe është duke kërcanuar të ngris padi daj kompanisë. Nëse është e mundur që kompania të bëjë ndonjë pagesë për kontabilistin, duhet të njihet një provision përndryshe duhet të hpaloset një detyrim kontingjent.</p>	<p>Ekipi i auditimit duhet të kërkojë konfirmim nga avokatët e kompanisë lidhur me ekzistencën dhe gjasën e ndodhjes së pretendimit nga kontabilisti.</p>
<p>Nuk është bërë asnjë harmonizim në mes të librit të blerjes dhe kartelave të furnitorëve që nga marsi deri në fund të vitit. Ky është një kontroll që po anashkalohet prandaj ka rrezik të shtuar të gabimeve në llogari të pagueshme të cilat mund të jenë nën/mbivlerësuar në fund të vitit.</p>	<p>Auditori duhet të shtoj testet e llogarive të pagueshme përfshirë harmonizimin e kartelave të furnitorëve me librin e blerjes për të testuar plotësinë.</p>
<p>Një pasuri qarkulluese në vlerë prej €360,000 është njohur në pasqyrën e pozicionit financiar dhe në pasqyrën e të ardhurave. Kjo shumë përfaqëson një arkëtim të pritur nga likuidatëorët e konsumatorit të kompanisë që</p>	<p>Diskutoni me menaxhmentin nëse kanë pranuar ndonjë njoftim zyrtar për pagesë dhe rishikoni korrespondencat. Nëse janë të sigurt se do të ndodhë atëherë trajtimi është në rregull. Nëse pagesa tashmë ka ndodhur,</p>

<p>kishte borxh €0.9m. Shuma prej €0.9m ishte shlyer nga pasqyrat. Mirëpo kompania nuk ka marr një njoftim formal nga likuidatorët që shuma prej 0.36 do të paguhet prandaj përfaqëson një pasuri kontingjente të mundshme. Për të qenë në pajtueshmëri me SNK 37, kjo shumë nuk duhet të njihet deri sa kompania virtualisht është e sigurt se do ta pranoj atë shumë. Pa ndonjë përgjigje nga likuidatori, përfshirja e kësaj shume në paqyra i mbivlerëson pasuritë.</p>	<p>parputhni pagesat e pranuar pas fundit të vitit. Nëse pagesa nuk është e sigurt, duhet të kërkohet largimi i pasurisë nga pasqyrat dhe shpalosja e një pasurie kontingjente në shënime të pasqyrave.</p>
---	---

### **Detyra 3**

Ju jeni menaxher i auditimit në firmën Rrepa Audit dhe jeni përgjegjës për auditimin e Kumbulla Shpk, një kompani që zhvillon dhe prodhon produkte të kozmetikës dhe i shpërndan ato te blerësit me shumicë. Fitimi para tatimit draft ishte €6.4m dhe pasuritë totale janë €37.2m për vitin financiar që përfundoi me 31 janar 2018. Auditimi do të filloj pas pak dhe janë ofruar informatat në vijim:

#### **Hulumtimi dhe zhvillimi**

Kumbulla Shpk ka shpenzuar €1.9m në vitin aktual në zhvillimin e nëntë produkteve të reja të kozmetikës, të gjitha prej të cilave janë në faza të ndryshme të zhvillimit. Pasi që të përmbushin kriteret e njohjes sipas SNK 38 Pasuritë e Patrupëzuara, Kumbulla Shpk i përfshinë kostot në pasuri të patrupëzuara. Pas fillimit të prodhimit, pasuritë e patrupëzuara amortizohen me metodën drejtvizore për një periudhë tre vjeçare. Menaxhmenti beson se politika e amortizimit është përaftrim i arsyeshëm i jetës së përdorimit të këtyre pasurive, pasi që në këtë industri ka kërkesë konstante për produkte të reja inovative.

#### **Zhvlerësimi**

Kumbulla Shpk ka një portfolio të madh të pronave, fabrikave dhe pajisjeve (pasuri joqarkulluese). Në mars 2017 kompania bëri një rishikim të përgjithshëm të pasurive joqarkulluese dhe përditësoi jetët e përdorimit, vlerën e mbetur, normat dhe metodat e zhvlerësimit për shumë kategori të këtyre pasurive. Drejtori financiar deklaroi se këto ndryshime ishin të domosdoshme për të reflektuar më mirë përdorimin e pasurive. Kjo rezultoi me ndryshime domethënëse në shpenzim të zhvlerësimit për disa pasuri këtë vit.

#### **Bonusi**

Bordi i kompanisë përbëhet nga shtatë drejtorë. Të gjithë kanë të drejtë për bonus bazuar në asetet neto në fund të vitit nga pasqyrat financiare draft, duke përjashtuar pasuritë e patrupëzuara. Detajet e bonusit janë të përfshira në kontratat individuale me drejtorët. Bonusi për vitin 2018 ishte paguar për secilin drejtor në shkurt 2018 dhe këto janë përshirë si shpenzime aktuale së bashku me pagat për vitin që përfundoi me 31 janar 2018. Nga legjislacioni vendor kërkohet që bonuset e drejtorëve të shpalosen ndaras në pasqyrat financiare të kompanisë.

#### **Kërkohet:**

- (a) Përshkruani procedurat thelbësore të cilat duhet të kryhen nga auditori për të përfutur dëshmi të mjaftueshme dhe përshtatshme të auditimit lidhur me shpenzimet e hulumtimit dhe zhvillimit të kompanisë. (5 pikë)
- (b) Përshkruani procedurat thelbësore të cilat duhet të kryhen nga auditori për të përfutur dëshmi të mjaftueshme dhe përshtatshme të auditimit lidhur me zhvlerësimin e pasurive joqarkulluse të kompanisë. (5 pikë)
- (c) Përshkruani procedurat thelbësore të cilat duhet të kryhen nga auditori për të përfutur dëshmit të mjaftueshme dhe përshtatshme të auditimit lidhur me bonuset e drejtorëve. (5 pikë)

Gjatë auditimit, ekipi i auditimit zbuloi se saldo e pasurive të patrupëzuara përfshinë €440,000 lidhur me njëren nga nëntë projektet e zhvillimit të produkteve, e cila nuk përmbushë kriterin e kapitalizimit. Pasi që projekti është në vazhdimësi, drejtori financiar tregoi se nuk është bërë ndonjë korrigjim në pasqyrat financiare të vitit 2018. Ai është i sigurt se projekti do të përmbushë kriterin e kapitalizimit në vitin 2019.

#### **Kërkohet:**

- (d) Diskutoni këtë çështje dhe shpjegoni ndikimin e saj në raportin e auditorit, nëse ka, nëse çështja mbetet e pazgjedhur. (5 pikë)

**[Total: 20 pikë]**



### Zgjidhja 3

#### a) Procedurat thelbësore për shpenzimet e zhvillimit

- Merrni listën e pasurive të patrupëzuara dhe rillogaritni saldon fillestare, shumat e kapitalizura gjatë vitit, amortizimin dhe saldon përfundimtare.
- Përputhni saldon përfundimtare nga libri kryesore me bilancin vërtetues dhe pasqyrat draft financiare.
- Diskutoni me drejtorin financiar arsytimin për jetën trevjeçare të përdorimit të pasurive
- Rillogaritni shpenzimin e amortizimit për një mostër të pasurive të patrupëzuara të cilat kanë filluar të prodhohen dhe konfirmoni nëse përputhet me politikën trevjeçare të amortizimit.
- Për nëntë projekte, diskutoni me menaxhmentin detajet e secilit projekt së bashku me fazat e tyre të zhvillimit dhe nëse janë kapitalizuar ose shpenzuar
- Për projektet e shpenzuara, përputhni koston me fatura dhe dokumente mbështetëse dhe nëse janë paraqitur në pasqyrën e të ardhurave.
- Për projektet e kapitalizuara përputhni koston me fatura dhe dokumente mbështetëse dhe konfirmoni fizibilitetin teknik duke diskutuar me menaxherët dhe duki i rishikuar raportet
- Rishikoni raportet e hulumtimit të tregut për të konfirmuar nëse kompania ka mundësinë e shitjes së produkteve dhe nëse ka një përfitim të mundshëm ekonomik në të ardhmen.
- Rishikoni shpalosjet e pasurive të patrupëzuara në pasqyrat financiare nëse janë në pajtueshmëri me SNK 38.

#### (b) Procedurat thelbësore për zhvlerësimin

- Diskutoni me menaxhmentin arsyeshmërinë e ndryshimit të normave të zhvlerëimit për pasuritë joqarkulluese (PJQ), jetët e përdorimit, vlerën e mbetur dhe metodat e zhvlerëimit për tu siguruar si kanë arritur në atë vendim.
- Konfirmo arsyeshmërinë e ndryshimeve duke krahasuar normat e ndryshuara të zhvlerëimit, jetët e përdorimit dhe metodave me mesataren e biznesit
- Rishiko buxhetet e shpenzimeve kapitale për vitet e ardhshme për të vlerësuar nëse jetët e përdorimit përputhen me periudhat e planifimit deri në zëvendësim të atyre pasurive
- Rishiko regjistrin e PJA për të vlerësuar nëse janë zbatuar normat e reja të zhvlerëimit.
- Rishiko dhe rillogarit fitimin dhe humbjen nga shitja ose heqja nga përdorimi i PJQ për të vlerësuar arsyeshmërinë e normave të reja të zhvlerëimit
- Përzgjedh një mostër të PJQS dhe rillogarit shpenzimin e zhvlerëimit për tu siguruar se regjistri i PJQ është i saktë dhe normat e reja janë duke u zbatuar si duhet
- Merr një listë të PJQ të ndara sipas kategorive dhe zhvlerëimit dhe krahaso me vitin e kaluar, nëse ka ndryshime domethënëse, diskuto me menaxhmentin
- Rishiko shpalosjen e zhvlerëimit në PF nëse është në pajtueshmëri me SNK 16.

#### (c) Procedurat thelbësore për bonuset e drejtorëve

- Merr listën e bonuseve të paguara dhe kryeni veprimet matematikore për të siguruar saktësinë dhe shumave në PF
- Rishiko listën e detyrimeve afatshkurta dhe konfirmo nëse bonuset ishin paraqitur si akuale në fund të vitit
- Përputh pagesat individuale të bonuseve me regjistrin e pagave
- Rillogarit pagesat e bonuseve dhe rishiko nëse janë përjashtuar pasuritë e patrupëzuara në llogaritjen e pasurive neto si bazë për llogaritjen e bonuseve
- Konfirmo shumën e secilit bonus të paguar pas fundit të vitit dhe përputh me raportin e bankës
- Përputh shumën e paguar për secilin drejtor me vendimet nga bordi dhe procesverbalët e takimeve për tu siguruar se bonused dhe pagesat tjera janë shpalosur në PF

- Merr përfaqësimet e shkruara nga menaxhmenti për të konfirmuar plotësinë e kompenzimeve për drejtorët përfshirë bonuset
- Rishikoni shpjosjet e bonuseve në PF për të konfirmuar plotësinë e tyre dhe përmbushjen e kërkesave ligjore.

(d) Ndikimi në raportin e auditorit

Njëri nga produktet e kozmetikës nuk përmbush kriterin e njohjes sipas SNK 38. Ky rast është në kundërshtim me kërkesat e SNK 38 prandaj kosto e projektit duhet të paraqitet si shpenzim e jo kapitalizim. Gabimi është material pasi që paraqet 6.9% të fitimit para tatimit (0.44m/6.4m) dhe 1.2% të pasurive neto (0.44m/37.2m) prandaj kërkon përkorrjim në pasqyra financiare. SNK 38 kërkon që kostot deri në këtë datë të shpenzohen; nëse projekti përmbush kriteret e SNK 38 në vitin e ardhshëm, atëherë vetëm kostot e reja nga ai moment duhet të kapitalizohen. Çfardo kosto që është shpenzuar nuk mund të kthehet në pasuri.

Nëse menaxhmenti refuzon të bëjë korriginimin e duhur në PF, opinionin e auditorit duhet të modifikohet. Pasi që gabimi është material por jo përhapës, opinionin e përshtatshëm është mre rezervë me shpjegim të arsyes në paragrafin e bazës për opinion.

#### **Detyra 4**

Eko-EQ është prodhues i pajisjeve që ndihmojnë në zvogëlimin e emisioneve toksike gjatë prodhimit të kemikateve. Kompania është rritur shumë shpejtë në tetë vitet e kaluara dhe kjo është kryesisht si rezultat se kompania i ofron konsumatorëve garancion të gjatë. Kompani ofron garancion pesë vjeçar dhe nëse ka problem gjatë kësaj periudhe, kompania do të rregullojë problemet, ose do të ofrojë produkte zëvendësuese.

Ju jeni menaxheri përgjegjës për auditimin e Eko-EQ dhe jeni duke kryer rishikimin përfundimtar të auditimit dhe jeni ballafaquar me dy çështjet në vijim:

#### **Gjendja e llogarive të arkëtueshme nga BOJA Shpk**

Eko-EQ ka një gjendje materiale të llogarive të arkëtueshme nga kompania BOJA. Gjatë auditimit të fundvitit, ekipi juaj ka rishikuar moshimin e llogarive të arkëtueshme nga ky konsumator dhe ka zbuluar se nuk është pranuar asnjë pagesë nga BOJA në gjashtë muajt e kaluar. Eko-EQ nuk ka lejuar që kjo llogari të konfirmohet. Në vend të kësaj, menaxhmenti i Eko-EQ ka siguruar ekipin tuaj se do të ofrojnë një letër përfaqësimi (deklarata të menaxhmentit) për të konfirmuar gjendjen përfundimtare të kësaj llogarie të arkëtueshme.

#### **Provizioni për garancione**

Provizioni për garancione i përfshirë në pasqyrat financiare është material. Ekipi i auditimit ka kryer testimin e llogaritjeve dhe supozimeve për këtë provision që janë konsistente me vitet e mëparshme. Ekipi ka kërkuar përfaqësim të shkruar nga menaxhmenti për të konfirmuar bazën edhe shumën e provizionit për të konfirmuar arsyeshmërinë. Menaxhmentit i ka mbetur të konfirmojë pranimin e këtij përfaqësimi.

#### **Kërkohet:**

(a) Përshkruani procedurat e auditimit që kërkohen sa i përket vlerësimeve kontabël. (5 pikë)

(b) Për secilën nga çështjet e mësipërme:

(i) Diskutoni përshtatshmërinë e përfaqësimeve të shkruara si formë e dëshmisë së auditimit; dhe (4 pikë)

(ii) Përshkruani procedurat shtesë të auditimit të cilat duhet të kryhen nga auditori në mënyrë që të arrijë në konkludim lidhur me gjendjen e secilës llogari (të arkëtueshme dhe provizioneve) në pasqyrat financiare. (6 pikë)

*Shënim: Pikët do të ndahen në mënyrë të barabart për secilën çështje.*

(c) Drejtorët e Eko-EQ kanë vendosur MOS t'i ofrojnë firmës së auditimit përfaqësime të shkruara (letra e përfaqësimit) për provizionin e garancioneve pasi që ata ndjejnë se nuk është e domosdoshme.

#### **Kërkohet:**

Shpjegoni hapat që auditori i Eko-EQ duhet të ndërmerr tani dhe ndikimin e kësaj ngjarje në raportin e auditorit si rezultat i refuzimit të ofrimit të letrës së përfaqësimit. (5 pikë)

**[Total: 20 pikë]**

#### Zgjidhja 4

(a) Procedurat të cilat duhet të adoptohen nga auditori sa i përket auditimit të vlerësimeve kontabël përfshijnë:

- Bisedat me menaxhmentin lidhur me faktin si janë bërë vlerësimet kontabël dhe mbi cilat të dhëna janë bazuar këto vlerësime.
- Përcaktoni nëse ngjarjet që ndodhin deri në datën para raportit të auditorit (pas periudhës raportuese) ofrojnë dëshmi sa i përket vlerësimeve kontabël.
- Rishikoni metodat e matjes që janë përdorur për të vlerësuar arsyeshmërinë e supozimeve të bëra.
- Testimi i efektivitetit të kontrolleve mbi mënyrën se si i bën menaxhmenti vlerësimet kontabël.
- Zhvilloni një pritje për vlerësimet e mundshme ose një shtrirje të shumave (prej-deri) për të vlerësuar vlerësimin e menaxhmentit.
- Rishikoni gjykimet dhe vendimet e bëra nga menaxhmenti në bërjen e vlerësimeve kontabël për të identifikuar nëse ka indikatorë të ndonjë paragjykimi nga menaxhmenti.
- Vlerësoni në përgjithësi nëse vlerësimet kontabël në pasqyrat financiare janë të arsyeshme ose përmbajnë anomali.
- përftoni dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme nëse shpalosjet e pasqyrave financiare lidhur me vlerësimet kontabël janë të arsyeshme.
- Merrni përfaqësimet e shkruara nga menaxhmenti dhe nëse është e përshtatshme nga personat e ngarkuar me qeverisjen nëse ata besojnë se janë përdorur supozime të mjaftueshme në vlerësimet kontabël.

(b) Llogaria e arkëtueshme nga BOJA shpk

(i) Përfaqësimet e shkruara të propozuara nga menaxhmenti kanë për qëllim verifikimin e vlerësimit, ekzistencës dhe të drejtave dhe obligimeve të një saldo materiale të të arkëtueshmeve. Pasi që menaxhmenti ka refuzuar të lejojë auditorin të konfirmojë llogarinë e arkëtueshme dhe pasi që ka pasur pak aktivitet në këtë llogari në gjashtë muajt e fundit, ka pak dëshmi të përfutuara nga auditori.

Ky përfaqësim do të përbënte dëshmi të prodhuar nga entiteti prandaj është më pak e besueshme se dëshmia e përftuar nga auditori ose dëshmia nga burimet e jashtme. Nëse sistemet e kontrolleve përkatëse operojnë me efektivitet atëherë kjo dëshmi bëhet më e besueshme. Përveç kësaj, nëse përfaqësimi është i shkruar në vend të asaj verbale, kjo e rritë besueshmërinë e burimit të dëshmisë.

Në përgjithësi ky përfaqësim është formë e dobët e dëshmive, pasi që ka opsione më të besueshme në dispozicion, siç është psh konfirmimi i llogarive të arkëtueshme por kjo nuk është ndërmarrë.

(ii) Në mënyrë që të arrihet konkludimi lidhur me gjendjen e llogarisë, duhet të kryhen procedurat në vijim:

- Diskutimi me menaxhmentin për arsyet pse është refuzuar kërkesa për konfirmim të llogarive të arkëtueshme.
- Rishikimi i periudhës pas përfundimit të vitit për të identifikuar nëse është pranuar ndonjë pagesë nga kompania BOJA.
- Rishikimi i korrespondencave me kompaninë BOJ për të vlerësuar arsyet për mos-pagesat e vazhdueshme.
- Rishikimi i procesverbaleve të takimeve të bordit dhe korrespondencat ligjore për të vlerësuar nëse ka pasur ndonjë veprim ligjor për të kompenzuar këto shuma nga konsumatori.
- Diskutoni me menaxhmentin nëse kërkohet ndonjë provizion për të shlyer llogaritë e- Konsideroni ndikimin në opinionin e auditimit nëse saldo e llogarive të arkëtueshme konsiderohet që ka anomali materiale.

Provizioni për garanci

(i) Në këtë rast auditori ka kryer disa teste mbi provizionet për të përfutur dëshmi të gjeneruara nga auditorit. Ekipi ka testuar llogaritjet dhe supozimet. Asnjëra nga këto nuk është dëshmi nga burimet e jashtme.

Vetë natyra e këtyre provizioneve do të thotë se është e vështirë për auditorin të përftojë dëshmi domethënëse të besueshme lidhur me nivelin e kërkesave në të ardhmen. Prandaj përfaqësimi i shkruar, edhe pse i gjeneruar nga vetë entiteti konsiderohet si dëshmi e dobishme pasi që ka disa alternativa tjera.

(ii) Në mënyrë që të arrihet konkludimi lidhur me gjendjen e llogarisë, duhet të kryhen procedurat në vijim:

- Rishikimi i periudhës pas përfundimit të vitit për të krahasuar nivelin e kërkesave që aktualisht janë bërë kundrejt shumave të ofruara.

- Rishikimi i nivelit të provizioneve nga viti i mëparshëm me shumat e kërkuara për të vlerësuar arsyeshmërinë e parashikimit nga menaxhmenti.

- Rishikimi i procesverbalit të takimit të bordit për të vlerësuar nëse kërkohet ndonjë ndryshim në nivelin e provizioneve si rezultat i rritjes ose zvogëlimit të nivelit të kërkesave nga konsumatorët.

(c) Hapat që duhet të ndërmerren nëse nuk ofrohen përfaqësime të shkruara për provizionet e garancisë

SNA 580 Përfaqësimet e shkruara ofron udhëzime për auditorët në rastet kur përfaqësimet kërkohen nga auditorët por menaxhmenti refuzon t'i jap ato.

Nëse menaxhmenti nuk i ofron përfaqësimet e shkruara për provizionet e garancisë, auditori i kompanisë duhet të diskutojë këtë çështje me menaxhmentin për të kuptuar pse janë duke refuzuar.

Përveç kësaj, auditori duhet të rivlerësojë integritetin e menaxhmentit të kompanisë dhe të konsiderojë efektin që ky rast mund të ketë në besueshmërinë e përfaqësimeve tjera (verbale ose me shkrim) dhe të dëshmive të auditimit në përgjithësi.

Auditori duhet të ndërmerr veprime të përshtatshme, përfshirë përcaktimin e efektit të mundshëm në opinionin e auditimit.

Ndikimi në raportin e auditimit

Pasi që auditori nuk është në gjendje të përftojë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të konkluduar që provizionet e garancisë janë të pastra nga anomalitë materiale, atëherë kërkohet një opinion i modifikuar i auditimit.

Provizionet e garancisë janë materialet por nuk janë përhapëse prandaj kërkohet një opinion me rezervë.

Raporti i auditimit kërkon një paragraf shtesë para paragrafit të opinionit i cili do të përshkruaj arsyen për modifikim; thjeshtë duket treguar që menaxhmenti ka refuzuar të ofroj përfaqësime të shkruara lidhur me provizionet për garanci prandaj ne nuk jemi në gjendje të japim opinion për këtë saldo. Paragrafi i opinionit do të korrigjohet të përfshijë fjalët 'përveç për'.

## **Detyra 5**

Ju jeni menaxher në firmën e auditimit Huti & Co dhe jeni duke konsideruar një numër të çështjeve etike të cilat janë paraqitur në disa nga klientët e auditimit afatgjatë të firmës.

### **Çaji Shpk**

Huti & Co është duke planifikuar auditimin e Çaji Shpk. Dje, partneri i anagazhimit, Adnan Burri, zbuloi se një tarifë domethënëse për shërbimet e sigurisë informative, shërbime që ishin ofruar nga Huti & Co, nuk ishte paguar ende. Adnani shpreson se kjo çështje do të zgjidhet me mirësjellje dhe konfirmoj se do ta diskutoj çështjen me drejtorin financiar Pajtimin, gjatë uikendit, pasi që të dy do të marrin pjesë në një ndejë për të festuar fejesën e vajzës së Adnanit me djalin e Pajtimin. (6 pikë)

### **Kafeja Shpk**

Kafeja Shpk është një kompani e madhe, viti financiar i së cilës përfundon me 30 qershor dhe është klient i Huti & Co për disa vite. Gëzimi, partner i auditimit në Huti & Co ka shërbyer si rishikues i kontrollit të cilësisë së auditimit për dy vitet e fundit për Kafeja Shpk. Në takimin e fundit, ai tha se nuk mund të jetë rishikues i kontrollit të cilësisë së auditimit për këtë klient pasi që është duke konsideruar angazhimin si drejtor joekzekutiv në komitetin e auditimit të Kafeja Shpk. Bordi i drejtorëve gjithashtu ka pyetur Huti & Co nëse mund të ofrojnë shërbime të auditimit të brendshëm për Kafeja. (5 pikë)

### **Lëngu Shpk**

Lëngu Shpk, një kompani e listuar në bursë, është njëri nga klientët më të mëdhenj të firmës Huti & Co. Vitin e kaluar tarifa e auditimit dhe shërbimeve tjera ishte €1.2m dhe këtë vit pritet të jetë €1.3m dhe përfaqëson 16.6% dhe 18.1% përkatësisht të të hyrave totale të Huti & Co. (4 pikë)

### **Kërkohet:**

Shpjegoni kërcënimet etike dhe masat mbrojtëse përkatëse në rastet e mësipërme.

**[Total: 15 pikë]**

## **Zgjidhja 5**

### **Çaji Shpk**

Për shkak të marrëdhënies së ngushtë personale në mes të partnerit të angazhimit dhe drejtorit financiar mund të paraqitet kërcënimi i interesit personal (vetiak). Gjithashtu si rezultat i tarifës së papaguar dhe natyrës së punës joaudituese për klientin e auditimit mund të paraqitet interesi personal.

Masat mbrojtëse:

Ndryshimi (rotacioni) i partnerit të angazhimit dhe rishikimi i punës së deritanishme të auditimit nga një partner tjetër i auditimit.

Kërcënimi i tarifës së papaguar mund të zvogëlohet duke kërkuar pagesën e tarifës para fillimit të angazhimit për auditim ndërsa për punët joaudituese, firma e auditimit duhet të rishikoj tarifat totale të pranuar nga klienti për tu siguruar se ato nuk tejkalojnë 10% të të hyrave totale për klientët që janë entitete me interes publik ose 15% të kompanive tjera.

### **Kafeja Shpk**

Neë Gëzimi pranon pozitën si drejtor joekzekutiv në Kafeja Shp, mund të krijohet kërcënim i interesit personal dhe vetërishikimi e që është aq i madh sa nuk mund të përdoret asnjë masë mbrojtëse për të zvogëluar kërcënimet në nivel të pranueshëm. Më tutje Kodi i Etikës së IESBA thekson se asnjë partner i firmës nuk duhet të shërbej si drejtor i klientit të auditimit, prandaj firma e auditimit duhet të tërhiëet nga angazhimi. Gjithashtu në këtë rast paraqitet kërcënimi i menaxhimit, pasi që auditori do të jetë i përfshirë në udhëheqjen e kompanisë dhe marrjen e vendimeve.

**Lëngu Shpk**

Lëngu Shpk është kompani e listuar dhe tarifat e pranuar nga firma e auditimit e kanë tejkaluar 15% të të hyrave totale për dy vite. Kjo duhet të shpalojë te personat e ngarkuar me qeverisjen e kompanisë dhe të zbatohen masat e përshtatshme mbrojtëse. Në këtë rast do të ishte e duhur nëse do të kryhej një rishikim i punës së auditimit para nënshkrimit të raportit të auditimit.